



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.243/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi-anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Arbenita Pllana, kandidate për kuvend të Komunës së Obiliqit nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Obiliq, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa, e parashtruar nga Arbenita Pllana nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ZL.Anr.243/2025, e datës 17.10.2025, e paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Obiliq, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidates Arbenita Pllana nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datë 15.10.2025, në QKN Obiliq, janë vërejtur parregullsi se shfletimi dhe regjistrimi në sistem të votave të kandidateve nuk përputheshin mes vete, sepse qëllimisht ky proces bëhej me shpejtësi të madhe. Kanë kërkuar që të hapet dhe rinumërohet kutia e votimit 1505/01, dhe në rast që vërehet manipulimi të hapen të gjitha kutitë dhe të behet rinumërimi në nivel komunal.

Në përgjigjen në ankesë të datës 18.10.2025, Komisioni Qendror Zgjedhor kanë deklaruar se të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, theksojnë se pretendimet e palës ankuese se i janë ndryshuar votat gjatë procesit të numërimit në fazën e futjes së të dhënave në sistem në QKN, lidhur me vendvotimin 0805/1 dhe 0805/02, për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, të datë 12 tetor 2025 ka njoftuar se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit në QKN. Tutje, kanë theksuar se pas pranimit të kërkesës nga PZAP, kanë kontaktuar më Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, (KKZ) të Komunës së Obiliqit, nga i cili ka marrë përgjigjen: “Më

lejoni të ju informoj se ne si Komision i Zgjedhjeve i kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme të Qendrës Komunale të Numërimit në Obiliq sipas ligjit dhe rregullores së QKN-së, dhe numërimi i votave është bërë nga 4 numërues të cilët janë nga subjektet politike” LVV, LDK, PDK dhe AAK, ku gjithçka është bërë nën vëzhgimin e kamerave të sigurisë si dhe është përcjellë edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike. Sa i përket kësaj në si Komision Komunal i Zgjedhjeve nuk kemi marr asnjë ankesë nga vëzhguesit në fjalë edhe pse kanë qenë prezent në QKN gjatë numërimit dhe as nga numëruesit të cilët ishin prezent”. Tutje KQZ ka theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimit me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të ankesës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Arbenita Pllana, kandidate për Kuvend të Komunës nga subjekti politik i LVV, në Obiliq, *se më datë 15.10.2025, familjari i saj kishte vërejtur parregullsi gjatë futjes së të dhënave dhe rezultateve në (QKN), në Obiliq, se shfletimet dhe regjistrimi në sistem të votave të kandidatëve nuk përputheshin mes vete, sepse qëllimisht ky proces bëhej më shpejtësi të madhe...*, janë të pa bazuara për faktin se e njëjta nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësja e ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë të vetme dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se ka ndodhur një veprim i tillë në QNR në Obiliq. Kurse pretendimet e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja vëren se “*Sa i përket kësaj ne si Komision Komunal i Zgjedhjeve nuk kemi marr asnjë ankesë nga vëzhguesit në fjalë edhe pse ka qenë prezent në QKN gjatë numërimit dhe as nga numëruesit të cilit ishin prezent*” (shih të bashkëngjitur deklaratën e (ZEKKZ).

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Arbenita Pllanaj, kandidate për asamble komunale nga radha e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është e pabazuar pasi që nuk ka bashkëngjitur asnjë provë përkatësisht pretendimi parregullsi gjatë futjes së të dhënave dhe rezultateve në (QKN), në Obiliq, se shfletimet dhe regjistrimi në sistem të votave të kandidatëve nuk përputheshin mes vete, sepse qëllimisht ky proces bëhej më

shpejtësi të madhe, mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë prove që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZLAnr.243/2025 datë 20.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.